



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.560/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NewCo Ferronikeli Complex LLC me seli në Drenas, kundër të paditurit Qeveria e Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative K.A.nr.289/22 i datës 30.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar Ankesa e paditësit NewCo Ferronikeli Complex LLC me seli në Drenas, Anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative KA.nr.289/22 i datës 30.11.2023, dhe Lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje dhe rigjykim

A R S Y E T I M

Me aktgjykimin e ankimuar të Dhomës së shkallës së parë, është vendosur si në vijim: I Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit NewCo Ferronikeli Complex LLC me seli në Drenas, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, për shkak të plotësimit të vendimit nr.19/4114/2-ZSP/481/19 datës 08.10.2019, me propozim që pjesa e vërejtjes së dhënë në faqen 3 të aktit administrativ të largohet në tërsi, II Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, për shkak të cënimit të dispozitave të procedurës kontestimore neni 182.2 (l) e LPK-së, me propozim që Dhomat së shkallës së dytë, ta aprovoj ankesën në tërsi si të bazuar, ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë KA.nr.289/22 i datës 30.11.2023 dhe të konstatohet se padia në këtë çështje është tërhequr.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesa, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjen se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Qeveria e Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, me vendimin përfundimtar nr. nr.19/4114/2-ZSP/481/19 datës 08.10.2019, ka aprovuar kërkesën e paditësit për Pëlqim Mjedisor për përdorimin e materialit RDF në furrat rrotulluese të Newco Ferronikeli Complex LLC Gllgovc.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë ndaj të paditurit respektivisht ka kundërshtuar aktin administrativ përfundimtar të paditurit, si të kundërligjshëm.

Dhoma e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datën 17.11.2023 në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar paditësit, e në prani të përfaqësueses së autorizuar të paditurës, dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor, me aktgjykimin e ankimuar, e Refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura vendimin kontestues e ka nxjerr me datën 08.10.2019 ndërsa paditësi ka paraqitur padinë kundër këtij vendimi kontestues me datën 20.11.2019, e cila datë vërtetohet nga shkresa e zyrës së pranimit, gjykata arrin në përfundim se padia e paditësit është e pas afatshme. Gjykata nuk u lëshuar në vlerësimin e provave ngase vlerësoi se elaborimi i tyre nuk është relevant për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe për vendosje në mënyrë meritore. Gjykata vendimin e mbështet ne nenin 26, 27, 46 të LKA-së.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës edhe sipas pretendimeve ankimore, gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (l) i LPK-së, i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij.

Kolegji vlerësoi, se përfaqëuesi i autorizuar i paditësit ka dorzuar në gjykatë me datën 14.11.2023 parashtresën me të cilën e njofton gjykatën se e tërheq padinë për shkak se nuk ka interes që të ndjek tutje këtë çështje përmes procedurës gjyqësore, dhe i propozon gjykatës që të merr aktvendim me të cilin konstatohet tërheqja e padisë. Ndërsa nga shkresat e lëndës Kolegji vlerësoi se Dhoma e shkallës së parë me datën 17.11.2023 ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, për shkak se i njëjti e ka pranuar ftesën për seancë me datën 17.10.2023, duke vazhduar më tutje me administrimin e provave dhe konstatimin e përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor.

Nga kjo gjendje e provave të lëndës, Kolegji vlerësoi se në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, dhe në arsyetim të aktgjykimit ankimor, nuk është shqyrtuar fare kërkesa e paditësit për tërheqje të padisë në kuptim të nenit 31 paragrafi 1 të LKA-së, që përcakton: *paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi. Në këtë rast gjykata e pezullon procedurën me vendim.* Prandaj Kolegji vlerësoi se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitës së nenit 182 par.2 pika (l) e LPK-së, që parasheh: *në qoftë se është vendosur për kërkesën për të cilën vazhdon procedura apo për të cilën më parë është nxjerr aktgjykimi i formës se prerë, ose prej të cilit paditësi njëherë ka hequr dorë ose për të cilin është lidhur pajtimi gjyqësor;*

Gjithashtu Kolegji gjeti se Dhoma e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit ka vlerësuar se padia e paditësit është e pas afatshme, duke mos vlersuar tutje provat e lëndës, dhe çështjen e ka vendosur me aktgjykim, në bazë të nenit 46 paragrafi 2 të LKA-së. Në këtë rast dhoma e shkallës së parë pas vërtetimit se padia e paditësit është paraqitur jashtë afatit ligjor, është dashur të zbatohet nenin 34 paragrafi 1 pika 1.1 e LKA-së.

Shkeljet e tilla respektivisht paqartësitë dhe kontradiktat si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, që kanë pasur ndikim në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar doemos është dashur të priset.

Në riprocedurë, Dhomat e Shkallës së parë, duhet të vendos lidhur me kërkesën e paditësit për tërheqjen e padis, dhe vendimin gjyqësor ta nxjerr sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

Nga arsyet e lartë cekura aktgjykimi i ankimuar, priset dhe lënda i kthehet Dhomës së shkallës së parë në rigjykim.

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.560/2024 datë 24.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Krenar Berisha